

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë



Dokument mbi Informacionin e Produktit të Sigurimit

Shoqëria e Sigurimit: Albsig Jetë sh.a.

Paketa: Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë

Albsig Jetë sh.a. është shoqëri sigurimi jete, e licensuar me Vendimin Nr. 171 datë 13.09.2019 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtarinë për të gjitha klasat e sigurimit të jetës, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument jep një përmbledhje të informacionit më të rëndësishëm, që lidhet me këtë produkt, por nuk është i personalizuar për ty. Të gjitha detajet që lidhen me informacionin para-kontraktor dhe kontraktor për këtë produkt, janë të disponueshme dhe mund të shkarkohen në faqen zyrtare të internetit iute.al/sigurimi-i-mbrojtjes-se-kredise/, së bashku me informacionin mbi tarifën e zbatuar për këtë produkt sigurimi. Në momentin që zgjedh të sigurohesh, duke pranuar kushtet e sigurimit dhe kryhet apo autorizohet pagesa e primit të sigurimit, informacioni i mësipërm do të të dërgohet së bashku me certifikatën e sigurimit edhe në rrugë elektronike.


Çfarë është ky lloj sigurimi?

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë është një **produkt vullnetar sigurimi jete**, i cili ofrohet për personat që marrin kredi dhe i mbron ata nga rreziku i pamundësisë së shlyerjes së kredisë, si pasojë e humbjes së jetës apo paaftësisë së përhershme si pasojë e aksidenteve. Në rast të ndodhjes së një prej ngjarjeve të listuara tek seksioni mbulimeve, shoqëria e sigurimit, paguan pjesën e mbetur të detyrimit të kredisë. **Ky produkt nuk përbën detyrim për të marrë kredinë, por është tërësisht në vullnetin e kredimarrësit.**



Çfarë mbulohet?

- ✓ Humbja e jetës nga shkaqe natyrore
- ✓ Humbja e jetës aksidentale
- ✓ Paaftësi e përhershme e plotë



Çfarë nuk mbulohet?

- ✗ Pjesëmarrje në veprimtari të paligjshme
- ✗ Pasoja nga konflikte të mëparshme
- ✗ Luftrat, revolucionet
- ✗ Sportet ekstreme
- ✗ Defekte fizike apo mendore paraekzistuese



A ka kufizime në mbulim?

- ! Individë më të rinj se 18 vjeç
- ! Individë mbi 65 vjeç
- ! Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm
- ! Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, sindroma organiko-cerebrale.



Ku je i mbuluar?

Paaftësi e përhershme e plotë

- ✓ Shqipëri

Humbja e jetës

- ✓ Në të gjithë Botën



Cilat janë detyrimet e tua?

- Të paguash primin e sigurimit, në mënyrë që mbulimi të hyjë në fuqi
- Të lexosh me kujdes informacionin para-kontraktor dhe të japësh dakordësinë për t'u bërë pjesë e kësaj skeme sigurimi, vetëm pasi të jesh bindur që ky sigurim është i përshtatshëm për ty, por në çdo rast përpara se të vijosh me pagesën e primit të sigurimit.
- Të na njoftosh nëse ka ndryshim në rrethanat tuaja, që të bëjnë të papërshtatshëm për të përfutur këtë mbulim.



Kur dhe si paguaj?

- Primi mund të paguhet njëherësh ose nëpërmjet planit me këste me interes zero, të mundësuar vetëm për klientët kredimarrës të iute
- Primi mund të paguhet nëpërmjet të gjitha mjeteve të njohura të pagesave të ligjshme në Republikën e Shqipërisë. Iute nuk pranon pagesa me para në dorë.



Kur fillon dhe kur mbaron mbulimi me sigurim?

Mbulimi fillon në datën e shënuar në Certifikatën e Sigurimit, e cila përkon me datën e fillimit të kredisë, mbi të cilën lëshohet ky mbulim, me kusht që të jetë paguar primin i sigurimit. Mbulimi përfundon kur:

- Ti anulon mbulimin brenda periudhës së lejuar 14-ditore
- Huaja është shlyer, refinancuar, apo transferuar.
- Ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe siguroesi i ka paguar përfituesit shumën e dëmshpërblimit.



Si mund ta anulosh kontratën?

Ti ke të drejtë ta anulosh kontratën brenda 14 ditëve nga lëshimi i certifikatës së sigurimit, që përkon me datën e fillimit të kredisë. Ne do të të rimbursojmë plotësisht primin e paguar, me përjashtim të rasteve kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit. Për ta anuluar kontratën, duhet të bësh një njoftim me shkrim në info@iute.al. Në rast se e ke shlyer plotësisht kredinë kontrata do të anulohet automatikisht. Përtej afatit 14-ditor nuk ka rimbursim të primit të sigurimit.